


Newsletter Bota e SIGAL UNIQA

Me SIGAL në European

Sponsor Krenar i Kombëtares Shqiptare të Futbollit



Newsletter "Bota e SIGAL UNIQA" ju njih me zhvillimet kryesore të Grupit për muajin maj 2024. Ky vmuaj ishte i mbushur me aktivitete dhe zhvillime motivuese për të ardhmen në të trija shtete të grupit: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Por pa harruar edhe kompaninë mëmë, "UNIQA Insurance Group", me seli në Vjenë.
Lexim të këndshëm

PËRMBAJTJA

E para në prime dhe në dëmet e paguara/ SIGAL UNIQA vijon të kryesojë tregun e sigurimeve në Shqipëri

“SIGAL UNIQA”, pjesë e Piramidës së Tiranës/ Ponari: Lokacioni më i ri i inovacionit në sigurime dhe edukimit financiar

18 vjet “SIGAL UNIQA Fond Pensioni”/ Ponari: Mijëra qytetarë dhe biznese na kanë besuar mirëqenien e tyre financiare

“Panairi i Punës dhe Karrierës në Universitetin e Durrësit”/ Të rinjtë, interes edhe për industrinë e sigurimeve

“Champions Health”, për herë të parë në Shqipëri/ SIGAL UNIQA prezanton paketat e sigurimit dedikuar sportistëve

Reflektim në shtëpinë e “Big Brother Vip”

Mbrëmje muzikore në bregdetin e Adriatikut/ Orkestra e Harqeve “SIGAL UNIQA” merr duartrokijtjet e të pranishmëve

KOSOVA

Lehtësimi dhe thjeshtimi i blerjes së sigurimeve/ Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit SIGAL UNIQA – Banka TEB

MAQEDONIA E VERIUT

“UNIQA A.D Shkup”, pjesë e “Panairit të Karrierës” në Universitetin e Evropës Juglindore

UNIQA Insurance Group

“Raporti i kapitalit rritet në 255%”, Xprimm: UNIQA: Pritshmëri pozitive për vitin 2024

Prezantohet fondacioni “UNIQA SEE Future”, mbështetje për një të ardhme më të mirë

“Impact Day”/ “Green Finance Alliance” vijon rritjen, UNIQA përsërit zotimin: Emetim i gazrave në të gjithë grupin deri në 2050

Jetojmë më mirë së bashku

SIGAL UNIQA Group Austria është sot një kompani me standarte tërësisht europiane, e cila i shërben me përkushtim klientëve, qytetarëve, komunitetit, u shërben atyre me të cilët ne shkëmbehem në rrugë, atyre që sapo dalim nga shtëpia dhe u themi mirëmëngjes, atyre me të cilët ndajmë jetën në qytet, atyre me të cilët ndajmë vlerat dhe jetën tonë të përditshme.

Çdo ditë SIGAL UNIQA punon, rritet, ecën përpara, zgjeron partnerët, stafi n me qëllimin e vetëm: ofrimin e një shërbimi sa më profesional ndaj klientëve që jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe pensionin privat ia besojnë pikërisht kësaj kompanie. Sepse çdo klient i SIGAL UNIQA, i vogël apo i madh, është pjesë e një familjeje të madhe që sot numëron mbi 1 milion anëtarë.

Prindërit janë një pjesë shumë e rëndësishme e jetës sonë.

Mos ki merak për prindërit!

Nëse dikur ishin ata që kujdeseshin për ne,
sot është koha të kujdesemi ne për ta!

Për këtë ka menduar SIGAL UNIQA Group
Austria, e cila vjen me një paketë sigurimi,
dedikuar pikërisht prindërve, si një dhuratë
nga fëmijët, "Mos ki merak për prindërit!"

Nr.1
në Sigurimin
e Shëndetit

MBULIMET:

- ✓ Dëmshpërblim në rast Tumori 5,000 euro
- ✓ Emergjencat mjekësore në rast sëmundje 1,000 euro
- ✓ Shpenzime mjekësore në rast aksidenti 500 euro
- ✓ Opinion i dytë mjekësor: Shërbim Asistence për çdo diagnozë në klinikat/spitalet private më të mira në Botë
- ✓ 1 vizitë okulistike falas
- ✓ 1 check up vjetor në klinikë të përcaktuar
- ✓ Konsulta me mjekë të licensuar, FALAS, direkt nga aplikacioni "Teleshëndet"



rritemi më mirë së bashku

Ngjarjet kryesore

E para në prime dhe në dëmet e paguara

SIGAL UNIQA vijon të kryesojë tregun e sigurimeve në Shqipëri

Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) publikoi këtë martë raportin mbi zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-prill 2024.

Sipas raportit, të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit kapën vlerën 7,089 milionë lekë, ose 3.96% më shumë se në janar-prill 2023. Ndërsa numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 424,991, me një rritje prej 10.61% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Rritje është shënuar edhe në dëmet e paguara bruto teksa AMF raporton se, ato arritën në rreth 2,788 milionë lekë, ose 32.27% më shumë se në periudhën janar-prill 2023.


Ndërkohë Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 90.63% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 9.31% dhe risigurimi me 0.056%.

Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 42.60% dhe primet e


SIGAL UNIQA LIDERE E TREGUT TË SIGURIMEVE



Ndarja e Tregut të Sigurimeve të Jo-Jetës Prill 2024



Ndarja e Tregut të Sigurimet e Jetës Prill 2024



shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 57.40% të totalit të tregut.

SIGAL UNIQA MBETET LIDERE NË TREG

Sa i përket kompanive që operojnë në Shqipëri, 8 në sigurimet e jo-jetës dhe 4 në ato të jetës, "SIGAL UNIQA" vijon të jetë më e madhja në treg, si për primet e shkruara ashtu edhe për dëmet e paguara tek klientët.

Në sigurimet e jo-jetës, SIGAL UNIQA zë 25% të tregut, ndërsa sa i përket dëmeve të paguara, me 23% të totalit mbetet edhe ajo që dëmshpërblen më shumë.

Edhe në sigurimet e jetës, SIGAL LIFE UNIQA vijon të ruajë leadershipin në treg me mbi 40% të totalit dhe me mbi 52% të dëmeve të paguara mbetet preferenca e parë për qytetarët.

Pra, me 26.5% të totalit të tregut (Jetë, Jo-Jetë), SIGAL UNIQA Group Austria vijon të jetë kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri.

“SIGAL UNIQA”, pjesë e Piramidës së Tiranës/ Ponari: Lokacioni më i ri i inovacionit në sigurime dhe edukimit financiar

“SIGAL UNIQA Group Austria” prej 25 vjetësh tashmë është kryefjala e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon.

Pjesë e “UNIQA Insurance Group”, kompania ka fituar besimin e qytetarëve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut jo vetëm për shërbimin profesional ndaj klientit, mbi 500 milionë euro dëme të paguara por edhe për inovacionin që ka sjellë vazhdimisht.

Dhe një kompani sigurimi kaq novatore, që ecën me hapat e zhvillimit të teknologjisë, nuk mund të mos ishte pjesë e ndërtesës më novatore në Tiranë.

Falë bashkëpunimit me Fondin Amerikan të Zhvillimit, një partner i hershëm dhe shumë i rëndësishëm i SIGAL UNIQA, dhe Bashkisë së Tiranës, një prej objekteve më të vizituara në kryeqytet, ka tashmë pjesë të mozaikut të saj të mirëideuar edhe kompaninë më të madhe të sigurimeve, “SIGAL UNIQA Group Austria”.

Themeluesi dhe CEO-s i kompanisë, Avni Ponari, teksa foli mbi rëndësinë që kanë sigurimet në përditshmërinë e gjithësecilit prej nesh, u shpreh se, zyra e “SIGAL UNIQA” pranë Piramidës së Tiranës nuk do të jetë thjesht një zyrë ku klientët aktualë dhe të rinj do të marrin shërbime sipas standarteve evropiane por edhe një qendër inovacioni, rekreativiteti dhe auditor leksionesh mbi sigurimet dhe edukimin financiar në përgjithësi.



“Është traditë e SIGAL-it që të jetë gjithmonë pranë gjërave të reja, pranë inovacioneve, pranë zhvillimeve dhe teknologjive



. Zhvendosja e një zyre këtu në Qendër të Teknologjisë, mund ta quaj, të Tiranës, afër Piramidës, është një risi për ne sepse me këtë ne përmbushim një detyrim që kemi ndaj stafit tonë dhe ndaj klientëve tanë.

Këtu do të bëhen trajnime të fushave të ndryshme, aq më tepër trajnime për të rinjtë që duan të njohin botën e sigurimeve, një nga më të rëndësishmet në botën e qytetëruar. Për të qenë afër me ne dhe të jenë të punësuarit tanë.

Por nga ana tjetër, ne kërkojmë që, në kuadër të dixhitalizimit dhe futjes së teknologjive të reja, ne t’ju shërbejmë klientëve edhe në pagesën e dëmeve në distancë”, u shpreh ndër të tjera Ponari.



18 vjet “SIGAL UNIQA Fond Pensioni” / Ponari: Mijëra qytetarë dhe biznese na kanë besuar mirëqenien e tyre financiare

“SIGAL UNIQA Fond Pensioni”, fondi më i madh i pensioneve private në Shqipëri festoon 18-vjetorin e themelimit.

Një rrugëtim i gjatë dhe me plot sfida por kur sheh se sa shumë siguri financiare u ka dhënë mijëra qytetarëve, lodhja zbehet.

Për të na folur më shumë mbi “SIGAL UNIQA Fond Pensioni” ne intervistuar CEO-n e tij z.Elvis Ponari.

“Viti 2024 është një vit jubile për “SIGAL UNIQA Fond Pensioni”, pasi këtë festojmë 18-vjetorin e themelimit.

18 vjet përkushtim, zhvillim, dhe siguri financiare për qytetarët shqiptarë.

Por kjo nuk është vetëm një arsye feste për ne; është gjithashtu një dëshmi e angazhimit tonë të palëkundur për të ndihmuar individët të sigurojnë të ardhmen e tyre financiare”, shprehet ai.

Por sa është sot vlera e aseteve të administruara nga “SIGAL UNIQA Fond Pensioni” dhe sa biznese dhe individë i kanë besuar të ardhmen e tyre financiare pikërisht këtij emri?

“Jam i lumtur të ndaj me ju faktin se, aktualisht “SIGAL UNIQA FOND PENSIONI” mbart një vlerë totale të aseteve prej rreth 28 milionë eurosh.

Sot, SIGAL UNIQA Fond Pensioni” ka privilegjin të bashkëpunojë me 134 biznese, të cilët na kanë besuar mirëqenien e tyre financiare. Gjithashtu, jemi krenarë të themi se numërojmë mbi 12 mijë klientë, që kanë bërë zgjedhjen e mençur për të investuar në të ardhmen e tyre me ne”, shprehet Ponari.

Ai tregon edhe disa prej avantazheve që ka anëtarësimi në “SIGAL UNIQA Fond Pensioni” “Bashkimi në një fond pensioni nuk është vetëm një lëvizje e zgjuar financiare pasi ajo ka edhe një sërë avantazhesh.

Ne ofrojmë një kthim më të lartë të investimeve krahasuar me llogaritë e kursimeve tradicionale – pastaj kush nuk do të donte pak para shtesë?



Dhe në rastin e pashmangshëm të vdekjes së klientit, investimi nuk humbet por trashëgohet tek anëtarët e tjerë të familjes, sepse siguria financiare është një çështje familjare!

Ndërkohë, duke qenë pjesë e Grupit më të madh të sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, SIGAL UNIQA Group Austria, anëtarët e “SIGAL UNIQA Fond Pensioni” përfitojnë zbritje ekskluzive në klinikat dhe spitalet më të mira.

Por me rastin e 18-vjetorit të themelimit, “SIGAL UNIQA Fond Pensioni” vjen edhe me një paketë dedikuar prindërve dhe të ardhmes të fëmijëve të tyre.

“Me rastin e 18-vjetorit të “SIGAL UNIQA Fond Pensioni” ne kemi sjellë një produkt të ri për fëmijën tuaj. Përmes një investimi prej 100 eurosh në muaj ju mund të kurseni njëkohësisht për universitetin dhe për të ardhmen e tyre”.

Në fund nuk mund të mungonte edhe një apel... “A e dini se ju mund të kurseni para nga paga juaj duke hapur llogarinë tuaj në “SIGAL UNIQA Fond Pensioni”

Ndaj, unë gjej rastin të ftoj të gjithë qytetarët shqiptarë të hapin llogarinë e tyre pranë fondit tonë. Me një investim fillestar prej vetëm 1,000 Lekë sot, ju mund të filloni të siguronit të ardhmen tuaj financiare. Nëse jeni të punësuar, trokisni tek financa e biznesit tuaj dhe i thoni t’ju kalojë X lekë për pension privat. Kaq e thjeshtë!”

“Panairi i Punës dhe Karrierës në Universitetin e Durrësit” / Të rinjtë, interes edhe për industrinë e sigurimeve



Panairi i Punës dhe Karrierës mbledhi në Universitetin e Durrësit “Aleksandër Moisiu” me qindra studentë, të interesuar për t’u punësuar pranë kompanive private.

Ata plotësuan formularët për t’iu nënshtruar më pas intervistave të punës.

Mes pjesëmarrësve në panair ishte edhe kompania më e madhe e sigurimeve në vend, SIGAL UNIQA Group Austria.

Gjatë eventit, të rinjtë paten mundësinë të njihen me mundësitë e karrierës që ofron SIGAL UNIQA por edhe të njiheshin me produktet unike që ajo ofron në tregun shqiptar.

“Sot, SIGAL UNIQA Group Austria kishte kënaqësinë të ishte prezent në “Panairin e Punës dhe Karrierës”, zhvilluar në ambientet e Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës.

Në një ambient frymëzues, patëm rastin të njohim studentë të shkëlqyer dhe të ndajmë përvojën tonë në fushën e sigurimeve, të diskutojmë me ta rreth mundësive për një karrierë të suksesshme në tregun e sigurimeve në Shqipëri, si dhe të jepnim më shumë informacion mbi atë që SIGAL UNIQA ofron.

Dëshirojmë t’ju falenderojmë për pritjen e ngrohtë dhe për interesimin tuaj të madh! Ne jemi të lumtur të ndajmë njohuritë dhe të jemi burim frymëzimi për të rinjtë që duan të ndërtojnë një karrierë të suksesshme”, shkruan “SIGAL UNIQA” në postimin e saj.

SIGAL UNIQA Group Austria, 25 vite lidere në treg

SIGAL u themelua në shkurt 1999 dhe prej vitit 2007 është pjesë e “UNIQA Insurance Group”, një prej grupeve më të mëdhenj të sigurimeve në Austri dhe Evropë.

Grupi “SIGAL UNIQA” operon suksesshëm në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut përmes 8 kompanive: 3 Sigurimi Jo-Jete, 3 Sigurimi Jete, 1 kompani risigurimi dhe 1 Fond Pensioni duke kryesuar tregun në këto shtete e duke qenë mes Top 50 kompanive më të mëdha në Europën Juglindore.

Falë strategjisë së ndjekur, modelit të biznesit, menaxhimit financiar, stafit profesional dhe korrektësisë kontraktuale kompania është sot lidere e tregut shqiptar dhe rajonal të sigurimeve.



jetojmë më
mirë së bashku

Sigurimi i Shtëpisë, Apartamentit dhe Biznesit

Mbroni investimin tuaj më të rëndësishëm:
Shtëpinë, apartamentin dhe biznesin
nga zjarri dhe katastrofat natyrore.



Blije online
duke skanuar
barkodin

Prona juaj,
Prioriteti ynë





Më shumë se një kompani sigurimi

Përgjegjësi sociale

“Champions Health”, për herë të parë në Shqipëri

SIGAL UNIQA prezanton paketat e sigurimit dedikuar sportistëve

SIGAL UNIQA Group Austria ishte pjesë e eventit të parë dedikuar mjekësisë sportive në Shqipëri, “Champions Health”, i mbajtur në sheshin “Italia” në Tiranë.

Në event, ku morën pjesë Rektori i Universitetit të Sporteve, ai i Mjekësisë, Presidenti i KOKSH, përfaqësues nga federata dhe klube të ndryshme në vend, kompania e sigurimeve “SIGAL UNIQA Group Austria” lançoi paketat e sigurimit dedikuar Sportistëve.

Gjatë prezantimit, përfaqësues të Departamentit të Shëndetit pranë SIGAL UNIQA u shprehën ndër të tjera se, mbrojtja financiare e sportistit nëse ky i fundit pëson një dëmtim në ndeshje apo në stërvitje, është politikë, e cila duhet iniciuar dhe mbështetur nga të gjitha federatat sportive në vend.

Rasti në Vlorë, ku gjatë Turit të 81 Çiklistik të Shqipërisë u aksidentuan disa çiklistë, e tregon më së miri këtë nevojë.

Sipas përfaqësuesve të SIGAL UNIQA, kompania lider në sigurime prej 25 vjetësh tashmë, ofron Sigurimin për Sportistë, i cili ka në fokus ekipet, klubet, ligat, shoqatat, kampet, kurset, turnetë, aktivitete sportive amatore, për të rinj dhe të rritur.

“Bashkë me këtë policë sigurimi, e cila mbulon cdo ngjarje aksidentale gjatë ndeshjes apo stërvitjes, përshin dhe shpenzimet për



diagnostikim (Skaner apo rezonancë), ndërhyrje kirurgjikale, medikamente, fasha, proteza të jashtme si edhe sigurimi në rast paaftësie të pjeshme apo të plotë”, thanë përfaqësues të SIGAL UNIQA.

“Sigurimi nga Aksidentet për çdo sportist” nga SIGAL UNIQA ofrohet në 3 paketa.

Paketa bazë:


- Shpenzime mjekësore emergjente me indikacion mjekësor në rast aksidenti gjatë seancave stërvitore dhe ndeshjeve
- Vizita me mjekë specialistë
- MRI CT
- Shpenzime për ilaçe
- Në rast të marrjes së shërbimeve në spital shtetëro, rimbursin të 50% të vlerës së shërbimit në spital privat
- Mbulim të shpenzimeve deri në 200 Euro

Paketa e Sigurimit 2:

- Shpenzime për vizita mjekësore dhe diagnostikuese
- MRI, CT deri në 300 euro
- Shpenzime për ilaçe
- Pajisje ortopedike deri në 100 euro
- Mbulim të shpenzimeve për ndërhyrje kirurgjikale deri në limit 3,000 Euro

“Paketa e Sigurimit 3”:

- Shpenzime për vizita mjekësore dhe diagnostikuese
 - MRI, CT deri në 500 euro
 - Shpenzime për ilaçe
 - Pajisje ortopedike deri në 100 euro
 - Mbulim të shpenzimeve për ndërhyrje kirurgjikale deri në limit 5,000 Euro
- SIGAL UNIQA ofron gjithashtu edhe paketat “Check Up për sportist”



Ekipi kombëtar është i siguruar me
SIGAL UNIQA





Reflektim në shtëpinë e “Big Brother Vip”



Shëndeti ishte biseda që ndanë me njëri-tjetrin banorët e shtëpisë më të famshme në Shqipëri, “Big Brother Vip.

Të nxitur nga kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve, SIGAL UNIQA Group Austria, ata nëpërmjet rrëfimeve të tyre, na kujtuan se:

Shqipëria është plot me spitale, klinika dhe laboratorë privatë, por qytetarët e Shqipërisë vazhdojnë të paguajnë fatura për shërbimet mjekësore në këto institucion.

Çmimet janë të shtrenjta, por me e shtrenjtë është jeta.

Çdokush mund të sigurohet! Pra të mos paguajë kur ka fatura spitalore dhe kjo është e thjeshtë, ekonomike, dhe e shpejtë.

Primi i sigurimit është 100 deri 500 herë më i ulët se përfitimi.

Një operacion në zemër mund të kushtojë 50,000 Euro dhe siguracioni vjetor kushton vetëm 200 – 500 Euro.

“Operacioni i zemrës ishte shumë i kushtueshëm. Unë po flas për eksperiencën që kam patur. Dhe operimi i zemrës ishte shumë i kushtueshëm dhe nëse unë do të kisha një siguracion, mua s’do më kishte kushtuar asgjë. Janë sëmundje që të kapin të papërgatitur. S’ke mundësi ekonomike. Dhe nuk është se ti do të ndërrosh makinën. Është sëmundje, është tjetri në krevat. Nuk ke kohë. E pastaj kemi parë shumë njerëz, të afërm, shokë e miq që marrin borxhe njëri-tjetrit, marrin kredi për sëmundje...”, rrëfeu dje në Big Brother VIP Romeo Veshaj.

Çfarë ofron SIGAL UNIQA Group Austria si mbështetje financiare ndaj sëmundjeve kritike, përfshirë tumoret dhe ato të zemrës.

“Jetë Plus”

Nëse zgjedh sot të sigurohesh, vetëm duke plotësuar një pyetje shëndetësore pas një periudhe pritje 6 mujore, do të kesh sigurim në të gjithë botën nëse diagnostikohesh me:

a) Tumor malinj; b) sëmundje zemre; c) transplant; d) ndërhyrje në kokë e) shtyllën kurrizore

Kjo policë Sigurimi:

- Pagan faturat e trajtimit mjekësor në çdo shtet të Europës për këto sëmundje:

- Pagan biletën e avionit, për pacientin dhe të afërmin që e shoqëron

- Pagan 100 euro për çdo ditë që zgjat trajtimi jashtë vendit.

Porosit tani ONLINE në <https://sigal.com.al/>

“Sigurimit anti-Tumor”

Nëse zgjedh sot të sigurohesh, vetëm duke ju përgjigjur një pyetje pas një periudhe pritje 6 mujore, do të kesh sigurim në të gjithë botën nëse diagnostikohesh me: a) Tumor malinj; b) Tumor beninj në kokë

- Merr paratë që të nevojiten për kurimin tënd, të gjitha menjëherë

- Shumën për të cilën kërkon të sigurohesh e zgjedh çdo individ, nga 5,000 deri 50,000 euro

- Pagesa vjetore për t’u siguruar fillon nga 50 euro në vit/person;

Shikoje çmimin këtu: <https://sigal.com.al/>

Mbrëmje muzikore në bregdetin e Adriatikut

Orkestra e Harqeve “SIGAL UNIQA” merr duartrokitjet e të pranishmëve

Marrja në sigurim dhe pagimi i dëmeve është detyrë për çdo kompani sigurimi. Por të jesh pranë komunitetit përmes sponsorizimeve të shumta në art, kulturë, sport etj shumë pak kompani e bëjnë.

Dhe një prej tyre është padyshim SIGAL UNIQA Group Austria, lidere e tregut të sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, e cila ka mbështetur gjatë gjithë kohës evente të ndryshme artistiko-kulturore.

Më i fundit ishte koncerti në një prej hoteleve më të njohur në bregdetin e Adriatikut, ditën e shtunë, ku Orkestra e Harqeve “SIGAL UNIQA” performoi në një takim biznesmenësh të rangut të lartë.

SIGAL UNIQA, gjithmonë pranë Artit dhe Kulturës

Prej 25 vjetësh tashmë kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në vend dhe rajon, SIGAL UNIQA Group Austria, i ka dhënë një rëndësi të veçantë edhe përgjegjësisë sociale teksa ka qenë mbështetëse e shumë aktiviteteve, në fusha të ndryshme.

Pikërisht në kuadër të Përgjegjësisë Sociale ndaj Komunitetit dhe nën moton “*jetojmë më mirë së bashku*”, SIGAL UNIQA Group Austria, në vitin 2009 ngriti Klubin e Artit dhe Kulturës.

Në këtë klub janë zhvilluar dhjetëra aktivitete kulturore ndër të cilat ekspozita pikturë, mbrëmje muzikore, portrete artistësh, promovime librash dhe seminare me tematika të ndryshme.

Duke besuar se arti në përgjithësi dhe muzika në veçanti lumturon njerëzit duke shtuar shpresën te ta, prej vitit 2013, pjesë e Klubit të Artit është Orkestra e Harqeve “SIGAL UNIQA”, e përbërë nga 15 instrumentistë profesionistë dhe një dirigjent.



Orkestra u ngrit nën idenë e themeluesit dhe drejtuesit të kompanisë, z. Avni Ponari ndërsa prej vitit 2013 ka dhënë me qindra koncerte në thuajse të gjitha qytetet e Shqipërisë, Vlorë, Elbasan, Durrës, Pogradec, Butrint, Shkodër, Lezhë, Valbonë etj, në Kosovë, rajon etj.



MJEKËT MË TË MIRË NË BOTË NË DISPOZICION
TË ÇDO INDIVIDIT TË SIGURUAR ME PAKETËN

“JETË PLUS”

DHE TRE OPINIONE
MJEKËSORE
PËR DIAGNOZËN

Kjo paketë sigurimi SIGAL UNIQA
ju mbulon shpenzimet deri në
1,000,000 Euro për këto sëmundje:

- ✓ Tumoret malinje;
- ✓ Ndërhyrje kardiokirurgjikale me teknikën “by pass”;
- ✓ Ndërhyrje kardiokirurgjikale për riparim dhe zëvendësim valvulash;
- ✓ Ndërhyrje kirurgjikale në kokë dhe në shtyllën kurrizore;
- ✓ Transplant i palcës së kockës dhe transplant organesh nga një dhurues i gjallë.

160€
DERI
NË **300€**
NË VIT/
PERSON



KOSOVA

Lehtësimi dhe thjeshtimi i blerjes së sigurimeve/ Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit SIGAL UNIQA – Banka TEB



SIGAL UNIQA Group Austria, kompania lider në tregun e sigurimeve në Kosovë, punon çdo ditë që të jetë pranë klientëve të saj jo vetëm duke sjellë produktet më të mira të sigurimit, duke paguar dëmet por edhe duke i bërë të gjitha këto procese më të lehta dhe më thjeshta për ta.

Ditën e sotme, drejtuesit e kompanisë kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me një tjetër bankë në vend, TEB.

Nënshkrimi i marrëveshjes është bërë nga Kryesuesi i Divizionit të shitjes për klient individual të Bankës TEB, Edmond Jashari dhe Drejtorët Ekzekutivë të SIGAL UNIQA Group Austria – Kosovë, Përparim Drini dhe Kaltrina Gashi.

Banka në fjalë do të jetë ndërmjetëse në shitjen e të gjitha produkteve të sigurimit që ofron SIGAL UNIQA në Kosovë, Jo-Jetë dhe Jetë, duke e lehtësuar akoma më shumë këtë procedurë.

“SIGAL UNIQA Group AUSTRIA – Kosovë dhe Banka TEB Sh.A. kanë nënshkruar një marrëveshje të re bashkëpunimi për ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse të produkteve të sigurimeve përmes bankës! Tani e tutje, Banka TEB do të veprojë si ndërmjetësues në shitjen e produkteve të sigurimeve “Jetë” dhe “Jo-Jetë” për SIGAL UNIQA, me qëllim të lehtësimit dhe thjeshtimit të blerjes së sigurimeve”, shkruan SIGAL UNIQA Group Austria – Kosovë në postimin e saj.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA – Kosovë, prej vitit 2003, është marka e preferuar e qytetarëve dhe bizneseve për sigurimin e Jetës, Shëndetit, Pronës dhe Automjetit. Sot, pas më shumë se 20 vjetësh, ajo mbetet lidere në treg, si për pozicionin që ze në treg ashtu edhe për dëmet e paguara tek klientët e saj.

MAQEDONI E VERIUT

“UNIQA A.D Shkup”, pjesë e “Panairit të Karrierës” në Universitetin e Evropës Juglindore



“UNIQA” ishte pjesë e edicionit të 17-të të “Panairit të Karrierës”, organizuar nga Qendra e Karrierës pranë Universitetit të Evropës Juglindore (South East European University) në Tetovë. Ky panair, i cili bashkoi një numër të madh kompanish, organizatash dhe institucionesh, u vlerësua maksimalisht nga “UNIQA” si një mundësi e shkëlqyer për të promovuar produktet unike që ofron kompania dhe për ti dhënë mundësinë studentëve dhe të interesuarve me mundësitë e punësimit që ofron ajo.

Kompania është gjithmonë e hapur ndaj prurjeve të reja, të talentuara dhe me dëshirë për tu bërë pjesë e tregut vital të sigurimeve ndërsa ka në fokus të saj diversitetin e burimeve njerëzore.

Shoqëria e sigurimeve “UNIQA A.D Shkup”, pjesë e “UNIQA Insurance Group”, operon suksesshëm në tregun maqedonas që prej vitit 2004.

Ajo ofron për të gjithë klientët të gjitha produktet e sigurimit të Jo-Jetës, përmes një rrjeti profesional zyresh, agjentësh dhe brokerësh të ndarë në të gjithë vendin.

Që prej themelimit, ajo ka paguar mbi 80 milionë euro dëme tek klientët e saj, ndërsa ka qenë gjithmonë pranë komunitetit ku operon duke sponsorizuar evente të ndryshme sportive, kullore etj. UNIQA, Jetojmë më mirë së bashku

UNIQA Insurance Group

“Raporti i kapitalit rritet në 255%”, Xprimm: UNIQA: Pritshmëri pozitive për vitin 2024



Grupi austriak i sigurimeve, “UNIQA Insurance Group”, pjesë e të cilit është edhe “SIGAL UNIQA Group Austria”, ka publikuar raportin mbi kapitalin e aftësisë paguese dhe raportin e qëndrueshmërisë për vitin 2023 duke konfirmuar “zhvillimet shumë pozitive të kompanive në Evropën Qëndrore dhe Lindore, të cilat dhanë një kontribut të konsiderueshëm prej rreth 50% në rritjen e përfitimit”.

“Viti financiar 2023 ishte edhe një tjetër vit i suksesshëm për UNIQA. Si grup, ne ishim në gjendje të rriteshim ndjeshëm në primet e shkruara me rreth 10%, pavarësisht stuhive të motit ekstreme, veçanërisht në Austri”, shprehet Kurt SVOBODA, CFO/CRO i Grupit, citon “Xprimm”. “Për vitin financiar 2024, ne po përqendrohemi në përmirësimin e mëtejshëm të biznesit tonë kryesor të sigurimeve në dy tregjet tona kryesore të Austrisë dhe EQL-së,” vijon SVOBODA, duke dhënë një perspektivë.

“Bazuar në një raport të aftësisë paguese prej të paktën 170%, ne përpiqemi t’i lejojmë aksionerët tanë të marrin pjesë në suksesin e kompanisë sonë në mënyrë progresive, pra me pagesa të

dividentëve në rritje çdo vit. Raporti i pagesës do të mbetet i pandryshuar deri në 60%”.

Primet e shkruara gjatë vitit 2023 u rritën me 9.7% (7,185.6 milionë euro), ndërsa fitimet para taksave ishin mbi pritshmëritë në 426.4 milionë euro.

Raporti i kombinuar është përmirësuar ndjeshëm në 89.4%, ku një rol të rëndësishëm në këtë ka luajtur edhe zhvillimi shumë i mirë i nënshkrimit të biznesit ndërkombëtar.

Në vitin 2023, vëmendje e veçantë i është kushtuar ekosistemit shëndetësor.

“Gjatë viteve të ardhshme, 245 milionë euro do të investohen në spitalet tona private, në rrjetin tonë të mjekëve, në telemjekësi, por edhe në kujdesin shëndetësor në punë dhe kujdesin 24-orësh në shtëpi”, shpjegon SVOBODA.

“UNIQA Insurance Group”, kompani e themeluar në vitin e largët 1811 dhe pjesë e tregut të sigurimeve në 17 shtete të ndryshme të Evropës, prej marsit 2007 është pjesë edhe e tregut rajonal, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut përmes Grupit “SIGAL UNIQA”.

“UNIQA” numëron rreth 17 milionë klientë ndërsa është vlerësuar nga “Standard & Poor’s” me “A”.

Prezantohet fondacioni “UNIQA SEE Future”, mbështetje për një të ardhme më të mirë

Legjenda e tenisit Goran Ivanišević dhe ylli i ri Luna Vujović, luajtën një ndeshje të pazakontë në Zagreb, si pjesë e njoftimit për themelimin e Fondacionit “UNIQA SEE Future”.

Investimi në talentet e rinj, në një të ardhme më të bukur dhe më të mirë, është adn-në e fondacionit të krijuar që synon ofrimin e mbështetjes për të rinjtë e talentuar në sport, kulturë etj.

“Me këtë lëvizje, ne kemi bërë një hap përpara drejt një mjedisi social”.

Qëllimi i fondacionit është të inkurajojë komunitetet lokale dhe të forcojë përfshirjen përmes programeve të ndryshme mbështetëse në përputhje me sloganin “jetojmë më mirë së bashku”, i cili inkurajon solidaritetin dhe bashkëpunimin për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Ideja e Fondacionit erdhi nga Grupi “UNIQA”, i cili bazohet në përmirësimin e jetës së klientëve dhe familjeve të tyre me oferta dhe shërbime inovative, por edhe duke mbështetur zhvillimin e përgjegjshëm të komunitetit”, theksoi Adel Bahtanović, presidente “UNIQA SEE”.

Në një botë gjithnjë e më komplekse plot sfida, nga ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore të luftërave dhe inflacioni, besimi dhe siguria po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për shoqërinë dhe ekonominë, por edhe për çdo individ. Pikërisht këtu UNIQA dëshiron të luajë një rol të rëndësishëm me angazhimin e saj social.

Puna e Fondacionit do të fokusohet në tre fusha: sport, kulturë dhe qëndrueshmëri.

Talenti i parë sportiv që Fondacioni do të mbështesë është tenistja Luna Vujović, fituese e vogël e Wimbledon. Bëhet fjalë për një nga shpresat më të mëdha të tenisit serb, e cila në vitin 2022 fitoi katër nga pesë finalët e Tenisit të Evropës në të cilat performoi.

“Jam i lumtur që përmes këtij fondacioni d



he bashkëpunimit me UNIQA mund të ndihmoj të rinjtë sepse jam i vetëdijshëm se sa e rëndësishme është mbështetja. Rrethanat kanë ndryshuar shumë në krahasim me kohën kur isha në fillimet e karrierës sime dhe kur mbështetësha në mbështetjen e familjes. Kur je i ri, në fillim është shumë e rëndësishme të mund të mbështetesh të dikush me përvojë dhe falë gjithçkaje që kam kaluar në jetën time, më vjen mirë që përmes fondacionit mund të mbështes talentet e reja”, tha Goran Ivanišević, imazh i “UNIQA” Kroaci, në prezantimin e fondacionit.

Fondacioni “UNIQA SEE Future” do të operojë në Evropën Juglindore: në Serbi, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Rumani dhe Mal të Zi.

“UNIQA Insurance Group”, kompani e themeluar në vitin e largët 1811, operon në 17 shtete të ndryshme të Europës duke numëruar edhe 17 milionë klientë.

Prej marsit 2007 është pjesë edhe e tregut rajonal, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut përmes Grupit “SIGAL UNIQA”.

“UNIQA” është vlerësuar nga “Standard & Poor’s” me “A”.

Impact Day

“Green Finance Alliance” vijon rritjen, UNIQA përsërit zotimin: Emetim i gazrave në të gjithë grupin deri në 2050



“Green Finance Alliance” zhvilloi takimin vjetor nën hashtagun #ImpactDay.

Anëtarët e iniciativës prezantuan një sërë historish suksesi se si po japin kontributin e tyre në transformimin e qëndrueshëm, ndërkohë që një anëtar i ri iu bashkua asaj, “Sparkasse Pöllau”.

Nisma deri tani përfshin 11 kompani financiare që së bashku kanë asete totale prej më shumë se 180 miliardë eurosh dhe të punësuar rreth 23,000 njerëz.

Mes tyre është edhe grupi i sigurimeve, “UNIQA Insurance Group”, pjesë edhe e tregut rajonal përmes Grupit “SIGAL UNIQA”.

“UNIQA” është kompania e parë e sigurimeve në Austri me objektiva ambicioze për të reduktuar emetimet.

“UNIQA konfirmon edhe një herë se anëtarësimi në “GFA” na mbështet efektivisht në arritjen e emetimeve të gazrave serrë, deri në vitin 2040 në Austri, deri në vitin 2050 në të gjithë grupin”, shkruan kompania në rrjetet e saj sociale.

Më poshtë gjeni detaje mbi objektivat e përkohshme të ‘UNIQA’:

Dalja nga përdorimi i qymyrit, naftës dhe gazit natyror

UNIQA ka një udhërrëfyes të qartë për largimin nga lëndët djegëse fosile si qymyri, nafta dhe gazi

natyror. Kompania tashmë nuk po bën më asnjë investim të ri në qymyr ose naftë, dhe nga viti 2024 asnjë biznes i ri nuk mund të merret në sigurim nëse përdor këto produkte.

Energjia e gjelbër në UNIQA

UNIQA po ndërmerr veprimet e duhura në fushën e ekologjisë së biznesit. Vënia në punë e sistemit të ri fotovoltaik në çatinë e selisë së UNIQA në verën e vitit 2023, më i madhi ndonjëherë në një ndërtesë të një kompanie, është një moment historik i madh: falë fuqisë së tij prej 125 kWp, ai do të jetë në gjendje të prodhojë 100,000 kWh energji elektrike për vit në të ardhmen. Kjo korrespondon me konsumin vjetor të rreth 30 familjeve dhe do të shmangë emetimet e rreth 21 tonë CO2 në total.

UNIQA ka rritur prodhimin e saj fotovoltaik të instaluar nga 50 kWp në mbi 400 kWp që nga viti 2020, një rritje 8-fish në vetëm pak vite. Deri në vitin 2035, prodhimi fotovoltaik duhet të jetë së paku 600 kWp.

UNIQA gjithashtu ka blerë 100% energji elektrike të gjelbër prej vitesh në Austri. Nga viti 2024 e në vazhdim do të blihet vetëm energji elektrike “green” e certifikuar me Ecolabel Austriak 46 (UZ 46 “Green Electricity”).

Rritemi më mirë së bashku.

SIGAL UNIQA ofron të gjitha llojet e sigurimeve për të gjitha llojet e bizneseve sipas standardeve europiane.

- ✓ Pronë
- ✓ Përgjegjësi
- ✓ Garanci
- ✓ Makineri dhe Automjete
- ✓ Punonjësit

Partneri juaj
në sigurime



Na kontaktoni
+355 4 2233 308
info@uniqa.al

